FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 155

Tiranë – E hënë, 31 gusht 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 29.7.2020	Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet "Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës", "Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës" dhe "Ndërtim i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë".....	9749
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 27.8.2020	Për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.....	9749
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 27.8.2020	Për miratimin e formës, të përmbajtjes dhe të elementeve të sigurisë së vizës elektronike.....	9749
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 27.8.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	9751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 27.8.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe të mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.....	9751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 27.8.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 345, datë 4.5.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës transballkanike Vlorë, faza II", të ndryshuar.....	9753

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 27.8.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i ish-Parkut Kuçovë".....	9758
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 27.8.2020	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2019 për projektin "Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës (DKTI)".....	9760
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 27.8.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit të ristrukturimit dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin ballkanik, fuqizimi i kapacitetit të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit, ratifikuar me ligjin nr. 9612, datë 21.9.2006.....	9762
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 663, datë 27.8.2020	Për miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoritet kontraktues, dhe "*Albchrome Holding*" sh.p.k., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit Klos dhe të uzinës së ferrokromit Burrel.....	9771
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 27.8.2020	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr. 98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reparti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	9774
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 27.8.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zonës 1/2, zonë e re për zhvillim, në njësinë administrative Thumanë, bashkia Krujë.....	9779

VENDIM
Nr. 641, datë 29.7.2020

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR PROJEKTET "NDËRTIM I KAMPUSIT TË RI TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS", "NDËRTIM I GODINAVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS" DHE "NDËRTIM I KORPUSIT TË POLICISË SË SHTETIT, POLICISË SHKENCORE DHE AKADEMISË SË SIGURISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ministrit të Kulturës, të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Bashkisë Tiranë, si autoritet kontraktor për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat e prokurimit publik për projektet "Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës", "Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës" dhe "Ndërtim i Kampusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë".

2. Bashkia Tiranë të administrojë procedurat e prokurimit publik për zhvillimin e projekteve, me objekt "Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës", "Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës" dhe "Ndërtim i Kampusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë".

3. Efektet financiare për zhvillimin e këtyre procedurave përballohen nga buxheti i shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 654, datë 27.8.2020

PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TND-në

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin, si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, të:

1. Z. Aleksandër Xhuvani, për një mandat 5-vjeçar;

2. Znj. Eglantina Zyka, për një mandat 5-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 655, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E FORMËS, TË PËRMBAJTJES DHE TË ELEMENTEVE TË SIGURISË SË VIZËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 22, të ligjit nr.108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës, të përmbajtjes dhe të elementeve të sigurisë së vizës elektronike, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS 1
FORMA, PËRMBAJTJA DHE ELEMENTËT E SIGURISË SË VIZËS ELEKTRONIKE

Forma dhe përmbajtja e vizës elektronike është si më poshtë vijon:

I. Viza elektronike do të jetë e printueshme në printer bardhë e zi, dokument format A4, PDF

II. Modeli i vizës elektronike

- Viza elektronike do të përmbajë:

- Bandën e titullit, ku në krye në qendër vendoset Stema e Republikës së Shqipërisë, në rreshtin e dytë shkruhet teksti "ELECTRONIC VISA"/ "REPUBLIC OF ALBANIA"/ "AL0000000e", ku vendoset nr. identifikues i vizës në sistem.

- Numri identifikues i vizës në sistem do te jetë me 8 karaktere dhe në fillim germat AL.

- Fushën ku është përcaktuar vendosja e fotos (G1).

- Fushën ku printohen të dhënat e që ruhen në MRZ (G2).

- Fushën ku do të printohet "Kodi i lexueshëm me makinë" (MRZ).

III. Tekstet dhe simbolet

Tekstet dhe simbolet që do të ketë të kompozuara viza elektronike, sipas modelimit të saj do të jenë:

- Stema e Republikës.
- Republika e Shqipërisë/Republic of Albania.
- AL.
- Harta e Shqipërisë.

IV. Teksti në vizën elektronike

1. Grupi i të dhënave G2, që përmban informacion mbi vizën, autoritetin lëshues, shtetasin e huaj posedues të vizës.

2. Dokumenti do të gjenerohet në format A4, PDF do të përmbajë dhe Kodin QR.

3. Kodi QR do të përdoret për të ruajtur të dhënat në format binar. Ky kod duhet të dëshifrohet nga lexuesi i pasaportave në PKK, nga telefoni celular etj.

4. Për konfigurimin e kodit QR, duhet të krijohet LDS (Logical Data Structure) duke përdorur MRZ (Zonën e lexueshme nga makina) të Vizës në DG1 (Grupi i të dhënave në vizë) dhe foton në DG2 (Fotografia në vizë).

5. LDS nënshkruhet dhe krijohet SOD (Document Sicurity Object).

6. Më tej SOD dhe LDS duhet të ruhen në Kodin QR, i cili do të printohet në vizën elektronike në format PDF dhe nëse skanohet, qoftë dhe nga telefoni, pasqyron të gjitha të dhënat e vizës.

7. Kodi QR, i cili do të printohet në vizën elektronike në format PDF, të përfshijë edhe të dhënat e pasaportës së aplikantit.

8. Dokumenti administrativ elektronik, përmban të dhënat e vulës elektronike të konvertuara vizualisht sipas formatit të mëposhtëm:

Paraqitja grafike e vulës institucionit (nëse është e aplikueshme)	/ Emri i institucionit lëshues
	Data dhe ora e vulosjes-sipas vulës kohore- timestamp
	Vlerën në hexadecimal/enkodim në string alfanumerik të hash të dokumentit apo vulës elektronike, të shfaqur në format të lexueshëm text apo në kod 1- apo dydimensional.
Shënim:	Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (emri i institucionit përkatës).

9. Forma e vulës elektronike është drejtkëndore dhe përmasat e saj nuk duhet të kalojnë 40% të gjerësisë së dokumentit apo 30% të lartësisë së tij (shembull: për formatin A4–84mm horizontalisht dhe 89mm vertikalisht);

10. Vula elektronike vendoset në pjesën e fundit, të faqes së fundit të dokumentit.

11. Për qëllime të vërtetimit të vlefshmërisë së dokumentit me vulë elektronike të printuar në letër mjafton skanimi i QR code që gjeneron adresën elektronike në të cilën dokumenti administrativ elektronik aksesohet përgjatë kohëzgjatjes së ciklit jetësor të tij, URL sipas specifikimeve të RFC 3986."

VENDIM
Nr. 656, datë 27.8.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të indeksit A, në kreun II, të vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet fjalia: "... Për të huajt që aplikojnë për vizë elektronike tipi C apo D, aplikohet një tarifë shtesë (fikse) për shërbimin, prej 20 eurosh, krahas tarifës së vizës së përcaktuar në aneksin nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij ...".

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 657, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH, TË LETËRMARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT TË SIGURUARA NGA SEKRETARIATI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO) TË QEVERISË ZVICERANE, NËN FONDIN E BESIMIT ME SHUMË DONATORË, PËR FUQIZIMIN E KONTABILITETIT DHE TË MJEDISIT TË MIRËBESIMIT NË EVROPËN JUGORE DHE AZINË QENDRORE, PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 251, DATË 9.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe të mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Logo BANKA BOTËRORE
BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

30 qershor 2020

Drejtuar: SH.S.Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar Znj. Ministre,

Shqipëri – Zhvillimi i një Projekti Kontabiliteti në Sektorin Publik
SAFE Granti nr. TF0A3277 dhe SAFE Granti nr. TF0A5134
Zgjatja e Datës së Mbylljes

I referohemi letërmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), e cila vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) i Qeverisë së Zvicrës ("Donatori") sipas Fondit të Besimit me Shumë-Donatorë për Forcimin e Mjedisit të Përgjegjshmërisë dhe Mirëbesimit në Evropën Juglindore dhe Azinë Qendrore, datë 3 prill 2018, për Zhvillimin e Projektit të Kontabilitetit në Sektorin Publik ("Projekti") dhe letrës suaj të datës 26 qershor 2020, me anë të së cilës Bankës Botërore i kërkohet zgjatja e Datës së Mbylljes të grantit të lartpërmendur të parashikuar sipas letërmarrëveshjes nga data 30 qershor 2020 deri më 31 dhjetor 2021.

Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 31 dhjetor 2021 si datën më të vonshme për qëllime të nenit III, 3.03 të aneksit të letërmarrëveshjes.

Me respekt,

(Nënshkrimi)

Linda Van Gelder

Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni: Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Z. Patrik Meier, zëvendësshef i Misionit, Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO)
Znj. Veronika Korkaj, drejtore e përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Kontraktimeve dhe Financimeve të Projekteve (GDCF), Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e përgjithshme dhe drejtore e përgjithshme e Departamentit për Zhvillimin dhe Qeverisjen e Mirë
Z. Patrizio Pagano, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

VENDIM
Nr. 658, datë 27.8.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 345, DATË 4.5.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS TRANSBALLKANIKE VLORË, FAZA II", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 345, datë 4.5.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 339 990 952.54 (treqind e tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 339 990 952.54 (treqind e tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.".

2. Vendimi nr. 365, datë 29.5.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 345, datë 4.5.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës transballkanike Vlorë, faza II"", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërf. trualli	Sipërf. ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e truallit, lekë	Vlera e ndërtimit, Lekë	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
1	8603	8//93	Vlorë	Eduard Lico	34.06		10,903		371,356	0	371,356.00	Saktësim dokumentacioni
2	8603	22-Sep	Vlorë	BP Shytaj, Dukaj	141.02		10,903		1,537,541	0	1,537,541.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	8603	9/22-nd	Vlorë	Zigur Serjanaj	0	45	10,903	32,516	0	1,463,220	1,463,220.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8603	18/10 T	Vlorë	BP Agace	322.9		10,903		3,520,579	0	3,520,579.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	8603	18/32	Vlorë	Besnik Skendaj	226.1	141.4	10,903	32,516	2,465,168	4,597,762	7,062,931.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Kufizim veprimesh
6	8603	20/142-ND	Vlorë	Dilaver Kalemaj, Ylli Kalemaj, Agim Kalemaj, Zaide Kalemaj, Luiza Kalemaj		198		32,516		6,438,168	6,438,168.00	Konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë. Në bazë të shkresës nr. 892 /2 datë, 31.07.2015 të Avokaturës së shtetit (Zyra Vendore) u bë ndarja e truallit nga ndërtesa, ku trualli kalon në pronësi të shtetit. Objekti është i llojit shtëpi banimi.
7	8603	20/147	Vlorë	Stavri Meci	137.2		10,903		1,495,892	0	1,495,892.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	8603	20/122Nd2	Vlorë	Stavri Meci		51	10,903	32,516	0	1,658,316	1,658,316.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	8603	20/122Nd1	Vlorë	Filip Meci		52	10,903	32,516	0	1,690,832	1,690,832.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	8603	20/122Nd3	Vlorë	Theofan Mece		27	10,903	32,516	0	877,932	877,932.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	8603	20/122T	Vlorë	Mihallaq Meci	47.3	0	10,903	32,516	515,712	0	515,712.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	8603	20/23/2-T	Vlorë	Bp Kucaj, Lako, Mici	94.34		10,903		1,028,589	0	1,028,589.00	Saktësim dokumentacioni
13	8603	20/42-T	Vlorë	Empire Invest Sol SHPK	261.93		10,903		2,855,823	0	2,855,823.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	8603	24/149	Vlorë	Agim Arifi	170		10,903		1,853,510	0	1,853,510.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	8603	29/418/2	Vlorë	Agron Resulaj Pullumb Resulaj Avduraman Resulaj Edmond Resulaj Tefta Braho Estela Rustemaj Ramon Rustemaj	227.18		10,903		2,476,943.5		2,476,943.54	Konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë. Pasuria 29/418 është prekur nga projekti i të dy fazave të rrugës " Transballkanike". Gjatë hartimit të proçedurave të VKM nr. 345, date 4.5.2016, nuk kanë qënë pasqyruar në ZVRPP-ja, veprimet për truallin dhe objektin e shpronësuar me VKM 857/2007. Veprimet janë bërë pas publikimit të VKM 345/2016. Nga Faza II preket e gjithë sipëfaqja 272.18 m², por për 45 m² është shpronësuar me VKM 857/2007 ndaj mbetet për këtë fazë 227.18 m².
16	8603	29/556-G	Vlorë	BP Dervishaj	96.69	96.69	10,903	32,516	1,054,211.00	3,143,972	4,198,183.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	8603	29/626/1	Vlorë	Bp Meleqi, Fetahu, Hasani	206.56		10,903		2,252,124	0	2,252,124.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	8604	4/287	Vlorë	BP.Gurea, Sharra, Ziu, Resuli, xhaferri	156.88		6,899		1,082,315	0	1,082,315.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	8604	4/120	Vlorë	Jorgji Vidhi	361.2		6,899		2,491,919	0	2,491,919.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Urdhër kufizimi
20	8604	4/128	Vlorë	Bp. Nexhipi	273.05		6,899		1,883,772	0	1,883,772.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	8604	5/29-ND	Vlorë	Fanije Bezhani		60	6,899	32,516	0	1,950,960	1,950,960.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	8604	5/106	Vlorë	Fanije Bezhani	44		6,899		303,556	0	303,556.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	8604	5/28-ND	Vlorë	Argjend Beg Salaj		42	6,899	32,516	0	1,365,672	1,365,672.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Urdhër kufizimi
24	8604	5/146	Vlorë	Qamil Lamce	66.73	42	6,899	32,516	460,370	1,365,672	1,826,042.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	8604	5/138	Vlorë	Piro Merkuri	105	94.8	6,899	32,516	724,395	3,082,517	3,806,912.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	8604	5/121	Vlorë	Napolon Prifti	83.79		6,899		578,067	0	578,067.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	8604	27/224	Vlorë	Bp.Dauti	350.5		6,899		2,418,100	0	2,418,100.00	Saktësim dokumentacioni
28	8604	27/83	Vlorë	Thoma Vasili	288.66		6,899		1,991,465	0	1,991,465.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Urdhër kufizimi
29	8604	35/115	Vlorë	Luigj Alijaj	357.87		6,899		2,468,945	0	2,468,945.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	8604	35/137	Vlorë	Bp. Janina Kona	477.27		6,899		3,292,686	0	3,292,686.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	8604	35/84	Vlorë	Mendu Sadiraj	336.54		6,899		2,321,789	0	2,321,789.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	8604	4/335/1	Vlorë	Qemal Tringaj	200.3		6,899		1,381,870	0	1,381,870.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	8604	4/44-ND	Vlorë	Qemal Tringaj		80	6,899	32,516	0	2,601,280	2,601,280.00	Saktësim dokumentacioni
34	8604	4/122-ND	Vlorë	Sotiraq Vidhaj		26.61		32,516	0	865,251	865,250.76	Pasuria eshte prekur pjeserishtnga realizimii projektit
35	8604	5/137	Vlorë	Muharrem Hameti	77.4		6,899		533,983		533,983.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	8604	35/67-ND	Vlorë	Haki dhe Xhevo Barjami		128	6,899	32,516	0	4,162,048	4,162,048.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Kufizim veprimesh
37	8604	35/134	Vlorë	Bp.Dauti	272.15		6,899		1,877,563	0	1,877,563.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Sigurim padie
38	8605	39/57	Vlorë	Viktor Jahaj	58.34		8,300		484,222	0	484,222.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	8605	39/200	Vlorë	Rasim Korkaj	56.68		8,300		470,444	0	470,444.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	8605	39/227	Vlorë	Rasim Korkaj	304.58		8,300		2,528,014	0	2,528,014.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	8605	39/18	Vlorë	Idai Shehu	74.87	40	8,300		621,421	758,530	1,379,951.00	Saktësim dokumentacioni. Llogaritur me metodën e kostos
42	8605	39/188	Vlorë	Bp Nelaj	50.55		8,300		419,565	0	419,565.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

43	8605	39/189	Vlorë	B.P Gjikoka	51.59	46	8,300	32,516	428,197	1,495,736	1,923,933.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	8605	39/144	Vlorë	Ahmet Sherifaj	35		8,300		290,500	0	290,500.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	8605	39/2+1-6	Vlorë	Viron Beqaraj		32	8,300	39,404.66	0	1,260,949	1,260,949.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	8605	39/2+1-1	Vlorë	Viron Beqaraj, Jeto Sinaj		38.7	8,300	39,404.66	0	1,524,960	1,524,960.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Urdhër kufizimi
47	8605	39/2+1-2	Vlorë	Shkelzen Beqiraj							0.00	Pasuria nr. 39/2+1-2, z.k. 8605, në pronësi të z. Shkelzen Beqiraj, miratuar në VKM-në nr. 345, datë 4.5.2016, me nr. rendor 47, e cila nuk preket nga vija e shpronësimit, në vlerën 1,694,400 lekë, hiqet nga shpronësimi, duke bërë edhe korrigjimin në VKM-në e sipërcituar.
48	8605	39/2+1-7	Vlorë	Ahmet Sherifaj		35		39,404.66	0	2,758,280	2,758,280.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Ndërtimi 2-kt.
49	8605	39/2+1-8	Vlorë	Ramiz Skendaj		19	8,300	39,404.66	0	748,689	748,689.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	8605	39/2+1-9	Vlorë	Ramiz Skendaj		19	8,300	39,404.66	0	748,689	748,689.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	8605	39/2+1-11	Vlorë	B.P Gjikoka		40		39,404.66	0	1,576,186	1,576,186.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	8605	39/146	Vlorë	Ramiz Skendaj	48		8,300		398,400	0	398,400.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	8605	39/13	Vlorë	Viron Memaj	110		8,300		913,000	0	913,000.00	Konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë. Pasuria 39/13 është e llojit "truall", me sipërfaqe 110 m², por në tabelën A , të VKM 365/2019 është përfshirë për shpronësim për 27.65 m² truall duke hequr gabimisht sipërfaqen 82.35 m², të përcaktuar në VKM nr. 345/2016. Sipas Dokumatacionit te paraqitur nga Bashkia Vlorë, trualli preket i gjithi nga vija e shpronësimit.
54	8605	36/128	Vlorë	Xhafer Xhaferi	38.6	32	8,300		320,380	1,248,610	1,568,990.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me metodën e kostos.
55	8605	36/127	Vlorë	Fatjon Veizaj	87	87	8,300	32,516	722,100	2,828,892	3,550,992.00	Saktësim dokumentacioni
56	8605	36/52	Vlorë	B.P Veizaj	248.18		8,300		2,059,894	0	2,059,894.00	Saktësim dokumentacioni
57	8605	36/104	Vlorë	Hysnie Hoxhaj	99.28	99.28	8,300		824,024	2,510,240	3,334,264.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto
58	8605	36/145	Vlorë	Sokol Mullai	35.56		8,300		295,148	0	295,148.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	8605	36/203	Vlorë	Xhevit Mullai	66.36	194	8,300	32,516	550,788	6,308,104	6,858,892.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto 2-kt
						65			0	2,384,200	2,384,200.00	
60	8605	30/102	Vlorë	Areti Duni	45.3		8,300	32,516	375,990	0	375,990.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	8605	30/103	Vlorë	Hiqmet Xhyheri	49.18	75	8,300		408,194	2,697,270	3,105,464.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Ndërtesa 2 kate Llog. me kosto
						75				2,724,790	2,724,790.00	
62	8605	30/96-nd	Vlorë	Avjon Bushaj		77	8,300	32,516	0	2,503,732	2,503,732.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	8605	30/132	Vlorë	Ferdinant Cobo	31.75		8,300		263,525	0	263,525.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	8605	30/46-nd1	Vlorë	Admirim Xhindi		20	8,300		0	563,440	563,440.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto
65	8605	30/94	Vlorë	Agim Xhyheri	209.4		8,300		1,738,020	0	1,738,020.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	8605	30/95	Vlorë	Bp Xhyheri	186.91		8,300		1,551,353	0	1,551,353.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	8605	30/1	Vlorë	Agron Haxhiraj	902.07		8,300		7,487,181	0	7,487,181.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	8605	30/1-ND1	Vlorë	Agron Haxhiraj		1149			0	41,322,180	41,322,180.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto
69	8605	30/3-nd	Vlorë	Agim Xhyheri		62.55			0	2,152,870	2,152,870.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto Objekti 2 kate
						62.55				2,152,870	2,152,870.00	
70	8605	30/10	Vlorë	B.p Ziu, Muco, Shahu, Resuli	134.51		8,300		1,116,433	0	1,116,433.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	8605	30/141	Vlorë	Hiqmet Xhyheri	62	124	8,300		514,600	4,505,044	5,019,644.00	Konfirmuar nga ASHK Vlorë. Në tabelën A, bashkëlidhur VKM nr. 365/2019 për z. Hiqmet Xhyheri është vendosur për shpronësim 10 m² truall , ndërkohë që shpronësimi e ka prekur në total për 62 m². Pra mbetet për tu përfshirë dhe diferenca prej 52 m2 truall, e percaktuar në 345/2016 dhe e hehur gabimisht në VKM 365/2019
72	8605	29/62	Vlorë	N.Ziu, F. Muco, J.Shahu, B.Resuli, P.Ballhysa	229.57		8,300		1,905,431	0	1,905,431.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	8605	29/5	Vlorë	N.Ziu, F. Muco, J.Shahu, B.Resuli, P.Ballhysa	151.09		8,300		1,254,047	0	1,254,047.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
74	8605	29/157	Vlorë	Bp Ziu Ballhysa Muco Shahu Resuli	195.38		8,300		1,621,654	0	1,621,654.00	Saktësim dokumentacioni
75	8605	29/156	Vlorë	B.p Xhaferri Sulka	249.09		8,300		2,067,447	0	2,067,447.00	Saktësim dokumentacioni
76	8605	29/155	Vlorë	Bp Sharra	255.45		8,300		2,120,235	0	2,120,235.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
77	8605	29/114	Vlorë	Bp Sharra, Gunga,	353.47		8,300		2,933,801	0	2,933,801.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
78	8605	29/34	Vlorë	Sotiraq Mitri	470.77	118	8,300	32,516	3,907,391	3,836,888	7,744,279.00	Saktësim dokumentacioni
79	8605	29/61	Vlorë	Bp Sharra, Gunga	10.7		8,300		88,810	0	88,810.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
80	8605	29/33	Vlorë	Llambi Mitri	154.29		8,300		1,280,607	0	1,280,607.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
81	8605	29/105	Vlorë	Ylli Shakaj	19.59		8,300		162,597	0	162,597.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
82	8605	29/160	Vlorë	Bp Xhaferri dhe Sulka	400.37		8,300		3,323,071	0	3,323,071.00	Saktësim dokumentacioni
83	8605	29/272	Vlorë	Bp Sharra	38.03		8,300		315,649	0	315,649.00	Saktësim dokumentacioni

84	8605	29/273	Vlorë	Bp Sharra, Gurga,	401.4		8,300		3,331,620	0	3,331,620.00	Saktësim dokumentacioni
85	8605	29/118	Vlorë	Asqeri Resuli	10.44		8,300		86,652	0	86,652.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
86	8605	29/31-ND	Vlorë	Asqeri Resuli		10.44		32,516		339,467	339,467.04	Konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit shtëpi banimi
87	8605	46/28	Vlorë	Sotir Kosta	277.67		8,300	32,516	2,304,661	0	2,304,661.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
88	8605	46/108	Vlorë	Lefter Nezha	128.89	101	8,300	32,516	1,069,787	3,284,116	4,353,903.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	8605	46/130	Vlorë	Durim Nezhaj	99.9	111	8,300	32,516	829,170	10,827,828	11,656,998.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Ndërtimi 3-kt
90	8605	46/31-nd	Vlorë	Agron Derolli		100		32,516		3,251,600	3,251,600.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	8605	46/93	Vlorë	Servet Hodaj	135.9	89	8,300	32,516	1,127,970	2,893,924	4,021,894.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
92	8605	46/33	Vlorë	Lefteri Guberaj	92.86	55.5	8,300	32,516	770,738	1,804,638	2,575,376.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
93	8605	46/37	Vlorë	B.p Llambro	24.5		8,300		203,350	0	203,350.00	Saktësim dokumentacioni
94	8605	46/38	Vlorë	Pandeli Llambi	41.05		8,300		340,715	0	340,715.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
95	8605	46/40	Vlorë	Bp Komini	28.53		8,300		236,799	0	236,799.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
96	8605	46/39-nd	Vlorë	Spiro Komini		76	8,300	32,516	0	2,471,216	2,471,216.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
97	8605	46/60	Vlorë	Llambi Komini	16.4		8,300		136,120	0	136,120.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Kufizim veprimesh
98	8605	46/101	Vlorë	Kristaq Komini	191		8,300		1,585,300	0	1,585,300.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
99	8605	46/103	Vlorë	B.P Loshi	100.94	63.6	8,300	32,516	837,802	2,068,018	2,905,820.00	Saktësim dokumentacioni
100	8605	46/131	Vlorë	Trifon Aleksi	90.41	74	8,300	32,516	750,403	2,406,184	3,156,587.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
101	8605	46/97	Vlorë	Arshi Abazi	121.05	72	8,300	32,516	1,004,715	2,341,152	3,345,867.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
102	8605	46/102	Vlorë	Arqile Janka	114.98	8.58	8,300	32,516	954,334	278,987	1,233,321.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
103	8605	46/53+1-2	Vlorë	Stiljan Todor		81		39,404.66	0	3,191,777	3,191,777.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
104	8605	46/53	Vlorë	Lluka Çaçani	109.4		8,300		908,020	0	908,020.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
105	8605	46/53+1-1	Vlorë	Jorgaq Çaçani		107	8,300	39,404.66	0	4,216,299	4,216,299.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
106	8605	49/97-ND	Vlorë	Ektor Xhaho		32.5		32,516	0	1,056,770	1,056,770.00	Konfirmohet nga ZVRPP Vlorë. Objekti është i llojit shtëpi banimi
107	8605	49/258	Vlorë	Ektor Xhaho	118.91		8,300		986,953	0	986,953.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
108	8605	49/262	Vlorë	Edmond Kordha	6.93		8,300		57,519	0	57,519.00	Saktësim dokumentacioni
109	8605	49/248	Vlorë	B.p Aliraj	64.92		8,300		538,836	0	538,836.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
110	8605	49/263	Vlorë	Bp Vengu	188.27		8,300		1,562,641	0	1,562,641.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
111	8605	49/255	Vlorë	Ndricim Hoxhaj	15.52		8,300		128,816	0	128,816.00	Plotësim dokumentacioni
112	8605	49/197	Vlorë	Hiqmet Nelaj	33.86	44.6	8,300		281,038	1,620,345.80	1,901,383.80	Konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë. Pasuria nr. 49/197 është truall dhe ndërtesë 2-kate. Objekti pritet deri tek vija e shpronësimit. Siperfaqja e shpronesuar 33.86 m2 truall, eshte miratuar ne VKM 345/2016.
113	8605	45/152	Vlorë	B.p Xhyheri	108.14		8,300		897,562	0	897,562.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
114	8605	45/153	Vlorë	B.p Xhyheri	234.81		8,300		1,948,923	0	1,948,923.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
115	8605	45/50	Vlorë	B.p Llanaj	35.75		8,300		296,725	0	296,725.00	Plotësim dokumentacioni
116	8605	45/50-N	Vlorë	B.p Llanaj		36	8,300		0	1,335,440	1,335,440.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llogaritur me kosto
117	8605	45/154	Vlorë	B.p Xhyheri	274.06		8,300		2,274,698	0	2,274,698.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
118	8605	45/318	Vlorë	Bp Leka	99.15		8,300		822,945	0	822,945.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
119	8605	50/23	Vlorë	Edmond Gjikoka	51.86	140	8,300	32,516	430,438	4,552,240	4,982,678.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
120	8605	50/24	Vlorë	Arjan Dautaj	33.97	133	8,300	32,516	281,951	7,218,552	7,500,503.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Ndërtim 2-kt
121	8605	30/66-ND	Vlorë	Djana Fiku		100.9	8,300		0	3,627,290	3,627,290.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llog. me kosto
122	8605	30/67-ND	Vlorë	Gjyliston Deromemaj		98.4	8,300		0	3,538,820	3,538,820.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Llog. me kosto
123	8605	30//11	Vlorë	N.Ziu, F. Muco, J.Shahu, B.Resuli, P.Ballhysa	97.28		8,300		807,424	0	807,424.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
124	8605	39/2+1-3	Vlorë	Agim Koburja	35.5	35.5	8,300	39,404.66	294,650	2,797,684	3,092,334.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Objekti 2-katësh
125	8605	30/115	Vlorë	Lavderim Muka	132	132	8,300	32,516	1,095,600	4,292,112	5,387,712.00	Saktësim dokumentacioni
126	8605	39/135	Vlorë	Agim Koburja	43		8,300		356,900		356,900.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
127	8605	45/71-T	Vlorë	B.P.Gjoni	7.03	0	8,300		58,349	0	58,349.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
128	8605	46/28-ND	Vlorë	Sotir Kosta		78	8300	32,516	0	2,536,248	2,536,248.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
129	8605	39/20	Vlorë	Idai Shehu	106.87		8300		887,021	0	887,021.00	Saktësim dokumentacioni.
130	8605	30/60-nd	Vlorë	Ferdinant Cobo		46.63		32,516	0	1,516,221	1,516,221.00	Saktësim dokumentacioni.
131	8605	36/54	Vlorë	Bp Hysaj	7.79	9.08	8300	32,516	64,657	295,245	359,902.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
132	8605	30/55-nd	Vlorë	Bp Mukaj		45		32,516		1,463,220	1,463,220.00	Saktësim dokumentacioni.
133		8605	30/59-Nd	Vlorë	Filip Rustemaj		19.6	8300	32,516	0	637,314.00	637,314
134	8605	39/234	Vlorë	Shpetim Votiçe	95	8300	788500				788,500.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.
135	8604	5/148	Vlorë	Mihal Peta	195	6899	1345305			0	1,345,305.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë.

136	8604	5/29-ND	Vlorë	Janaq Bezhani			0	22.98	51846.7	1191437.17	1,191,437.17	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit godinë banimi. Çertifikata e pronësisë është lëshuar me procedurën e bërë nga Bashkia Vlorë sipas VKM-së nr. 608 , datë 05.09.2012, ndryshuar me VKM-në 133, datë 11.02.2015 për kalim pronësie. Gjatë proçedurave të VKM-së nr. 345, datë 04.05.2016, ka qënë pasuri shtet.
137	8605	46/137-T	Vlorë	Besnik Beshiri, Andon Beshiri, Eduart Beshiri, Kadim Xhelili, Niko Beshiri, Theodhori Beshiri, Panajot Beshiri	139	8300	1153700			0	1,153,700.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Nga konfirmimi i bërë nga ZVRPP-ja Vlorë në fazën e hartimit të procedurave të shpronësimit për VKM-në nr. 345, datë 4.5.2016 rezulton që kjo pasuri të ketë qënë PPV, pasuria nr. 46/35
138	8605	46/137-ND1	Vlorë	Luiza Ajazi, Sabire Beshiri, Xhuljeta Beshiri				8.25	38099.48	314320.71	314,320.71	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit apartament. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 46/137, vol. 45, faqe 137. Nga konfirmimi i bërë nga ZVRPP-ja Vlorë në fazën e hartimit të procedurave të shpronësimit për VKM-në nr. 345, datë 4.5.2016 rezulton që kjo pasuri të këtë qënë PPV, pasuria nr. 46/35.
139	8605	46/137+1-1	Vlorë	Luiza Ajazi, Sabire Beshiri, Xhuljeta Beshiri				25.3	38099.48	963916.844	963,916.84	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Apartament. Kati i parë. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 46/137-t, vol. 45, faqe 137. Nga konfirmimi i bërë nga ZVRPP-ja Vlorë në fazën e hartimit të procedurave të shpronesimit për VKM nr. 345, datë rezulton që kjo pasuri të ketë qënë PPV, pasuria nr. 46/35.
140	8605	46/137+1-2	Vlorë	Beshir Beshiri				30.9	38099.48	1177273.93	1,177,273.93	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Apartament. Kati i parë. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 46/137-t , vol. 45, faqe 137.
141	8605	46/137+1-3	Vlorë	Besnik Beshiri				11.5	38099.48	438144.02	438,144.02	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Apartament. Kati i parë. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 46/137-t , vol. 45, faqe 137. Nga konfirmimi i bëre nga ZVRPP Vlorë në fazën e hartimit të procedurave të shpronësimit per VKM-në nr. 345, datë rezulton që kjo pasuri të ketë qënë PPV, pasuria nr. 46/35.
142	8605	46/137+1-4	Vlorë	Theodhora Beshiri, Andon Beshiri, Niko Beshiri, Panajot Beshiri, Eduart Beshiri				70.2	38099.48	2674583.5	2,674,583.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Apartament. Kati i pare. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 46/137-t, vol.45, faqe 137. Nga konfirmimi i bërë nga ZVRPP-ja Vlorë në fazën e hartimit të procedurave të shpronësimit për VKM-në nr.345, datë rezulton që kjo pasuri të ketë qënë PPV, pasuria nr. 46/35.
143	8605	46/139	Vlorë	Albert Hyskaj, Fatime Hyskaj	168	8300	1394400	52	38099.48	1981172.96	3,375,572.96	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit banim.
144	8605	36/214	Vlorë	Zija Hoxhaj, Hysnie Hoxhaj			0	30.55	46399.48	1417504.11	1,417,504.11	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit apartament banimi.
145	8605	39/2+1-10	Vlorë	Viron Memaj			0	46	38099.48	1752576.08	1,752,576.08	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit apartament.
146	8605	39/2+1-9	Vlorë	Viron Memaj			0	46	38099.48	1752576.08	1,752,576.08	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është i llojit apartament.
147	8605	30/12	Vlorë	Fatos Muço, Pranvera Ballhysa, Nimfa Ziu, Judit Shahu, Bahir Resuli	42.88	8300	355904				355,904.00	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
							TOTALI				**339,990,952.54**	

VENDIM
Nr. 660, datë 27.8.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM I ISH-PARKUT KUÇOVË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i ish-Parkut Kuçovë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 52 609 731 (pesëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 52 609 731 (pesëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Kuçovë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Kuçovë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Kuçovë.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM ISH PARKUT KUÇOVË"

NR.	VENDNDODHJA	Emri Mbiemri i pronarit	TË DHËNAT E PASURISË				LLOJI I PRONËS	LLOJI I PRONËS		Sipërfaqe për shpronësim (m2)	Çmimi truall lekë/m2	Vlera në lekë për Truall	Sipërfaqe për shpronësim (m2)		Çmimi mesatar i banesës /apartamentit nga ZRPP 36000 minus vleren e tokes 2040	VLERA PËR NDËRTESË	OBJEKTE TË TJERA	VLERA TOTALE PËR SHPRONËSIM (LEKË)	Shënim
			Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Volumi	Faqe	Tokë	Ndërtesë		Tokë			Ndërtesë		36000-2040				
							Truall	Banim	Shërbim	Truall			Banim	Shërbim					
1	KUCOVË	Vasil Simon Gjika dhe Katerina Leksi Gjika	2310	6/159+1-2	23	117		55					55		33960	1,867,800		1,867,800	
2	KUCOVË	Altin Avdyl Malaj	2310	6/561	41	130	160	55	105	160	2040	326,400	55	105	33960	6,810,076		7,136,476	
3	KUCOVË	Altin Avdyl Malaj dhe Anduela Thoma Malaj	2310	6/561+1-1	42	42		134.9					134.9		33960	4,581,204		4,581,204	
4	KUCOVË	Arben Izet Tabaku	2310	6/194-ND	18	46	-		50	-				50		1,008,088		1,008,088	
5	KUCOVË	Arjan Haxhem Qato	2310	6/196	26	219	239		115	239	2040	487,560		115		1,639,394		2,126,954	
6	KUCOVË	Adrian Vasil Shuka, Denada Vasil Shuka dhe Sokol Vasil Shuka	2310	6/156-ND2	17	213	-		2145	-						5,785,479		5,785,479	
7	KUCOVË	Donika Kastriot Tafili dhe Elton Shpëtim Tafili	2310	6/207	42	2	134	14.6	18.5	134	2040	273,360	14.6	18.5	33960	908,054		1,181,414	
8	KUCOVË	Ligor Sifit Rogozi	2310	6/168-ND	25	117	-		61	-				61		954,300		954,300	urdhër kufizimi
9	KUCOVË	Murat Ali Benja	2310	6/314	29	64	2713		1025	2713	2040	5,534,520		1025		11,626,692	8,440,909	25,602,121	urdhër kufizimi
10	KUCOVË	Vangjel Jani Pjetri	2310	6/197	26	240	173		65.6	173	2040	352,920		65.6		1,515,653		1,868,573	
11	KUCOVË	Vasil Simon Gjika	2310	6/209	27	75	94		18	94	2040	191,760		18		305,562		497,322	
TOTALI										**3513**		**7,166,520**				**37,002,302**	**8,440,909**	**52,609,731**	

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
2. Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.

VENDIM
Nr. 661, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2019 PËR PROJEKTIN "PËR NJË TRANSPORT PUBLIK UDHËTARËSH MIQËSOR ME MJEDISIN NË METROPOLIN E TIRANËS (DKTI)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2019 për projektin "Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës (DKTI)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK 2019 PËR PROJEKTIN "PËR NJË TRANSPORT PUBLIK UDHËTARËSH MIQËSOR ME MJEDISIN NË METROPILIN E TIRANËS (DKTI)"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 120/2019 datë 9 maj 2019),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Në zbatim të Marrëveshjes gjermano-shqiptare të datës 21 tetor 1988 mbi Bashkëpunimin Teknik do të mbështetet projekti "Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës (DKTI)", nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 4.000.000,00 euro (me fjalë: katër milion euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft ftir Intemationale Zusammenarbeit – GIZ GmbH).

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1, dhe garanton, që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

4. Premtimet financiare për projektin e Bashkëpunimit Teknik të përmendur në paragrafin 1 dhe shumën e Bashkëpunimit Teknik të përmendur në paragrafin 2 do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit përmendur në nenin 2 dhe eventualisht kontratat e financimit. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31

dhjetor 2023. Nëse kontratat e zbatimit dhe eventualisht të financimit lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2

Hollësirat e projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve, që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projektit në kuptimin e nenit 1, paragrafët 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe eventualisht financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Neni 3

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit, dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimburson me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane vlerën e TVSh-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin të mbajtura në këtë kontekst merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

4. Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej këtë projekt. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, të datës 21 tetor 1988.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim duke respektuar një afat paraprirës prej gjashtë muajsh.

3. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë, më 26.6.2020, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË

VENDIM
Nr. 662, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT DHE FUQIZIMIT TË SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN NË SISTEMIN BALLKANIK, FUQIZIMI I KAPACITETIT TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË KONTROLLIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9612, DATË 21.9.2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit të ristrukturimit dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin ballkanik, fuqizimi i kapacitetit të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit, ratifikuar me ligjin nr. 9612, datë 21.9.2006, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Ambasada e Italisë Tiranë, më 13.8.2019
Tiranë Nr. prot. 3082

NOTË VERBALE

Ambasada e Italisë në Tiranë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin t'i referohet notës verbale nr. 6804, datë 17.7.2019, me të cilën Ministria juaj, në emër të qeverisë shqiptare, ka propozuar ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për realizimin e "Programit të ristrukturimit dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësisë së transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit", lidhur në Tiranë, më 10 korrik 2006:

1. Për palën italiane, duke marrë parasysh ligjin italian nr. 125 të vitit 2014:

- "Ministria e Punëve të Jashtme" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar";
- Akronimi "MAE" zëvendësohet në të gjitha nenet me "MAECI" ;
- Çdo referencë për UTC është eliminuar në të gjitha nenet;
- "Artigiancassa" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Arka e Depozitave dhe Huave";

2. Për palën shqiptare, duke pasur parasysh vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017;

-"Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë";

-"Akronimi "MECE" zëvendësohet në të gjitha nenet me "MIE" ;

3. Në nenin 3 (Përshkrimi i Programit) janë përfshirë në aktivitetet e propozuara për t'u realizuar nga Programi "Punët dhe shërbimet inxhinierike për rehabilitimin e rrjetit elektrik të Orikumit";

4. Në nenin 7 (Mënyra e marrjes së shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve) fjalët që përmban "MANUALI I PROCEDURAVE (miratuar nga Komisioni Evropian, më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshimet përkatëse, me përjashtim të pjesës mbi rregullat e nacionalitetit dhe origjinës, e cila do të përshtatet sipas specifikave të kredisë italiane të ndihmës, lidhur me: "Tenderin e punimeve,

furnizimeve dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta" dhe sipas përcaktimeve në shtojcat 2 dhe 3, zëvendësohen me fjalët "që përmban shtojca 3, duke përjashtuar pjesën e rregullave mbi nacionalitetin dhe origjinën";

5. Shtojcat 1 (Programi i ristrukturimit dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësisë së transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit), dhe 3 (Mënyra e ekzekutimit dhe e menaxhimit të kredisë së ndihmës), zëvendësohen nga shtojcat e reja 1 dhe 3 bashkëlidhur këtij shkëmbimi notash verbale.

6. Kohëzgjatja e Marrëveshjes shtrihet deri në fund të aktivitetit dhe shlyerjes së kredisë.

Kuptohet që Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, lidhur në Tiranë, më 10 korrik 2006, do të interpretohet, zbatohet dhe integrohet në përputhje me kuadrin legjislativ dhe rregullues aktual italian për çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim.

Për këtë qëllim, Ambasada ka nderin të komunikojë se Qeveria e Republikës së Italisë pranon propozimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe është dakord që Nota e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kjo përgjigje, të përbëjnë një Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë amenduese e Marrëveshjes për realizimin e "Programit të ristrukturimit dhe fuqizimit e sistemit elektrik shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësisë së transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit", lidhur në Tiranë, më 10 korrik 2006, që do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet, me të cilat Palët do të kenë komunikuar zyrtarisht kryerjen e procedurave të brendshme të ratifikimit.

Ambasada e Italisë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë, ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

(firmë, vulë)

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë
TIRANË

SHTOJCË 1
PROGRAM PËR RISTRUKTURIMIN DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN E TIJ NË SISTEMIN E BALLKANIT; FUQIZIMI I KAPACITETIT TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMI I KONTROLLIT

Duke vijuar bashkëpunimin e frytshëm të krijuar në sektorin e energjisë elektrike që nga viti 1992, që ka sjellë investime prej rreth 65 milionë euro, prej të cilave rreth 5.5 milionë si dhuratë, MAECI/DGCS e pranoi kërkesën e Qeverisë shqiptare për të përdorur pjesën e mbetur (21,494,303 euro) të kredisë ndihmë të dhënë në prill 2002, për blerjen e energjisë elektrike, për financimin e Qendrës së re të Dërgesave dhe dhënien e një kredie ndihme prej 30 milion euro për financimin e linjës 400 kV Elbasan 2 – Tirana 2 dhe Nënstacionet përkatëse dhe për punimet dhe Shërbimet Inxhinierike për Rehabilitimin e Rrjeteve Elektrike të Orikumit.

Përmbajtja e këtij Programi pasqyron atë që parashikohet në Dokumentin e Projektit të përgatitur së bashku me Palën shqiptare dhe artikulon në detaje punimet, shërbimet dhe furnizimet e nevojshme për zbatimin e tij.

Përmes këtij programi, i cili integrohet me ato të donatorëve të tjerë (Banka Botërore, BEI, BERZH-i, Japonia, Zvicra, Spanja dhe Norvegjia), do të lejohet integrimi i vendit në tregun Rajonal të Energjisë Elektrike.

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i besueshmërisë së shërbimit të energjisë elektrike do të kontribuojë në ngritjen e nivelit të jetesës së popullsisë dhe do të nxisë investimet e reja të kapitalit të huaj në vend.

Më konkretisht na propozohet që të:

Pajisim ATSO-në me mjetin thelbësor për menaxhimin e duhur dhe ekonomik të sistemit të vet elektrik dhe të përfshijë Shqipërinë në tregun evropian të energjisë elektrike, duke favorizuar hyrjen e saj zyrtare në "Union for the Coordination of Transmission of Electricity" (UCTE) të zonës 2: Evropa e orientuar nga Jugu. Organizmi që grupon të ashtuquajturat "Transmission System Operators" të këtyre vendeve: Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Greqi, Rumani, Serbi, Mali i Zi dhe Turqi.

REZULTATET E PRITSHME

Me qëllim arritjen e objektivit specifik të treguar më sipër, është parashikuar, brenda harkut kohor trevjeçar të programit, arritja e rezultateve të mëposhtme;

1. Racionalizimi i shkëmbimit të energjisë me vendet e rajonit

2. Përmirësimi i besueshmërisë së shërbimit të energjisë elektrike, me një ulje të mëtejshme të humbjeve teknike.

AKTIVITETE QË SYNOJNË ARRITJEN E REZULTATEVE

Për secilin nga rezultatet e mësipërme, janë parashikuar të realizohen veprimtaritë e mëposhtme:

a) shërbime inxhinierike për asistencë të natyrës teknike të ATSO-së për ekzekutimin e tenderëve dhe për realizimin e projekteve;

b) ndërtimi i një ndërtese të re për të strehuar Qendrën e Dërgesave dhe Telekontrollit (CDT) dhe për të vendosur selinë e ATSO-së;

c) furnizimi dhe montimi i impianteve për CDT e re;

d) zëvendësimi i disa pajisjeve manovër, mbrojtja dhe matja në Nënstacionet ekzistuese të përfshira në instalimin e CDT;

e) implementimi dhe modernizimi i sistemit të Telekomunikacionit;

f) ndërtimi i nënstacionit të ri 400/ 200 kv të Tirana 2;

g) ndërtimi i linjës 400 kV midis Elbasan 2 e Tirana 2 (rreth 48 km);

h) punime dhe shërbime inxhinierike për rehabilitimin e rrjetit elektrik të Orikumit;

Programi gjithashtu parashikon një sërë masash të nevojshme për të siguruar menaxhimin e duhur të saj:

a) Do të krijohet një "*Project Implementation Unit"*, PIU-ATSO, pranë ATSO-së, që do të përfitojë nga mbështetja teknike dhe financiare nga MAECI/DGC-AISC;

b) MAECI/DGCS-AISC do të sigurojë të gjitha burimet e nevojshme për monitorimin e vetë programit;

c) ATSO do të sigurojë të gjitha burimet financiare për të mbuluar shpenzimet lokale (punët e mundshme civile, taksat, detyrimet doganore etj.);

Qeveria shqiptare, për realizimin e këtij programi, merr përsipër të kryejë veprimet e mëposhtme:

1. Zbatimin e kushteve të treguara në tabelën më poshtë;

2. Të miratojë, sipas afateve të treguara në tabelën e cituar, masat e domosdoshme për arritjen e rezultateve;

3. Të përfundojë, përpara nënshkrimit të Konventës Financiare, procesin e mbylljes administrative të ndërhyrjes për blerjen e energjisë elektrike nga Italia, siç tregohet më poshtë.

	Logjika e ndërhyrjes	***Kushtet***
Objektiv specifik	Përmirësimi i kapacitetit menaxhues dhe ndërlidhës të sistemit elektrik të Shqipërisë, për integrimin e tij të plotë në tregun e energjisë elektrike të Evropës Juglindore	Vazhdimi i procesit të Unbundling Autonomi progresive operacionale dhe funksionale e ATSO-së. Vazhdimi i politikës tarifore
Rezultatet e pritshme	Racionalizimi i shkëmbimit të energjisë me vendet e Rajonit. Përmirësimi i besueshmërisë së shërbimit të energjisë elektrike dhe reduktimi i humbjeve teknike	- Vazhdimi i procesit të Unbundling -Autonomi progresive operacionale dhe funksionale e ATSO. (brenda gjysmës së vitit 2006);
Aktivitetet	Ndërtimi i Qendrës së re të Dërgimit dhe Telekontrollit dhe ndërtimi i selisë së re të ATSO-s;	Sigurimi i terrenit dhe i licencave përkatëse para shpalljes së tenderit
	Ndërtimi i Linjës 400 kV Elbasan - Tiranë	Dhënia e së drejtës së kalimit të linjës;
	Ndërtimi i Nënstacionit të ri 400 kV të Tirana 2	Sigurimi i terrenit dhe licencave përkatëse para shpalljes së tenderit
	Punime dhe shërbime inxhinierike për rehabilitimin e Rrjetit Elektrik të Orikumit	Sigurimi i terrenit dhe licencat përkatëse para shpalljes së tenderit
	Shërbime inxhinierike dhe mbikëqyrjeje	Miratimi i planit të prokurimit
	Menaxhimi i Programit –Mbështetje për PIU-ATSO	Krijimi i PIU brenda ATSO
	Menaxhimi i programit. Monitorimi i programit nga ana e DGCS	Nënshkrimi i marrëveshjes

Të dyja palët angazhohen që së bashku të përcaktojnë dhe zbatojnë të gjitha masat që do të konsiderohen të nevojshme të përfshihen, nëse, gjatë zbatimit të programit, verifikohet pamundësia e përmbushjes së kushteve të lartpërmendura.

TABELA 1. SKEMA FINANCIARE E PROGRAMIT

Aktivitetet	Përshkrimi	Kredi ndihmëse (€)	Dhuratë (€)	Financime lokale (€)	Totali (€)
Realizimi Qendrës së Dërgimit dhe Telekontrollit	Furnizime dhe montime	17.494.303,00	0	0	17.494.303,00
Ndërtimi i një selie të re për Qendrën e Dërgimit dhe për ATSO	Furnizime dhe punime	5.207.700,66	0	1.000.000,00	6.207.700,66
Ndërtimi i Linjës 400 KV Elbasan 2 – Tirana 2	Furnizime, punime civile dhe montime	9.724.613,58	0	0	9.724.613,58
Ndërtimi i Nënstacionit të Tirana 2 (400 KV)	Furnizime, punime civile dhe montime	17.615.787,84	0	1.000.000,00	18.615.787,84
Punime dhe shërbime inxhinierike për rehabilitimin e rrjetit elektrik të Orikumit	Shërbime dhe punime	1.245.561,16	0	0	1.245.561,16
Mbikëqyrje punimesh dhe shërbime inxhinierike	Shërbime	206.336,76	0	0	206.336,76
Menaxhimi i programit – Mbështetje për PIU-n	Fond për furnizime, blerje ekonomike, shërbime të vogla	0	145.000,00	0	145.000,00
Menaxhimi i programit-mbikëqyrje dhe monitorim	Fond ekspertësh	0	180.000,00	0	180.000,00
Detyrime doganore	Taksa lokale		0	4.000.000,00	4.000.000,00
	Totali	**51.494.303,00**	**325.000,00**	**6.000.000,00**	**57.819.303,00**

Kontributi i qeverisë italiane pra do të jetë:
- Kredi ndihmëse 51.494.303,00 euro
- Komponent si dhuratë 325.000,00 euro
- Totali 51.819.303,00 euro
Kontributi i ATSO do të jetë pra prej:
6.000.000,00 Euro

Kostoja e përgjithshme e nismës rezulton kështu e barabartë me 57.819.303,00 euro.

SHTOJCË 3
KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET THEMELORE PËR LIDHJEN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE

Kjo shtojcë përcakton klauzolat etike dhe parimet themelore në të cilat bazohet përzgjedhja e kontraktuesit, lidhja dhe zbatimi i kontratave të furnizimit, shërbimet dhe punimet e parashikuara nga Marrëveshja. Për çështjet që nuk përfshihen në këtë shtojcë, zbatohet legjislacioni i referencës së përcaktuar nga Marrëveshja.

1. KËRKESAT E KONTRAKTUESIT

1.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshje, procedurat e përzgjedhjes së kontraktuesit janë të hapura për operatorët ekonomikë të Bashkimit Evropian, për ata të parashikuar në nenin 25 të direktivës 2014/24/BE dhe atyre që zotërojnë kërkesat dhe autorizimet e parashikuara nga legjislacioni lokal.

1.2 Autoriteti kontraktor mund t'u vendosë operatorëve ekonomikë një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme të pjesëmarrjes, me kusht që ato t'i përmbahen dhe të jenë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

1.2.1 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë kërkesa për të garantuar që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar Tenderin. Për këtë qëllim Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore

minimale të përcaktuar, duke përfshirë një xhiro të caktuar minimale në sektorin e aktivitetit objekt të kontratës, me kusht që të mos kalojë dyfishin e vlerës së përcaktuar në kontratë, përveç rrethanave të justifikuara siç duhet, në lidhje me rreziqet specifike që lidhen me natyrën e punimeve, shërbimeve ose furnizimeve. Për kontratat e ndarë në lote, ky paragraf zbatohet për secilin lot. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor mund të përcaktojë xhiron minimale vjetore, që operatorët ekonomikë duhet të kenë, duke iu referuar grupit të lotëve, në rast se ofertuesit të suksesshëm i janë dhënë për të ekzekutuar disa lote njëkohësisht.

1.2.2 *Kapaciteti Teknik dhe profesional*: Autoriteti Kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të kenë burimet njerëzore dhe teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me një standard të përshtatshëm të cilësisë. Autoriteti Kontraktor, mund të kërkojë, në veçanti, që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm të përvojës të provuar me referenca të përshtatshme në lidhje me kontratat e ekzekutuara më parë. Në procedurat e tenderit për furnizime që kërkojnë punime të vënies në punë ose instalime, shërbime, apo punime, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të kryer shërbime të tilla mund të vlerësohet duke iu referuar kompetencës, efikasitetit, përvojës dhe besueshmërisë së tyre.

1.2.3 *Kualifikimi në ushtrimin e aktivitetit profesional*; autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një regjistër profesional ose tregtar të mbajtur në shtetin në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar.

1.3 Dokumentet e tenderit tregojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele minimale të kapacitetit dhe mjetet e përshtatshme të provës.

1.4 Nëse një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për sa i takon kritereve që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, autoriteti kontraktor, kërkon që operatori ekonomik dhe subjektet e përmendura më lart të jenë bashkërisht të përgjegjshëm për zbatimin e kontratës.

1.5 Në rastin e kontratave të punimeve, kontratave të shërbimit ose operacioneve të vënies në punë ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti kontraktor tregon në dokumentet e tenderit detyrat thelbësore që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga vetë ofertuesi ose, në rastin e një oferte të paraqitur nga një grup operatorësh ekonomikë, nga një pjesëmarrës i këtij grupi operatorësh.

1.6 Përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe nuk mund të fitojnë apo lidhin kontratat përkatëse, konkurrentët, të cilët:

1.6.1 Janë të dënuar me një dënim të formës së prerë, për një nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet në nenin 57, paragrafi 1, i direktivës 2014/24/BE: pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, vepra terroriste ose vepra penale që lidhen me veprimtari terroriste, pastrim të produkteve me prejardhje kriminale ose financime për terrorizmin, punën e të miturve, ose forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore;

1.6.2 Janë të dënuar me një dënim të formës së prerë, për çdo krim tjetër nga ku rrjedh, si dënim plotësues, pamundësia për të kontraktuar me administratën publike të një prej Palëve të kësaj marrëveshjeje ose të shtetit në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.3 Kanë kryer shkelje të rënda, të konstatuara përfundimisht, në lidhje me detyrimet për pagimin e taksave ose kontributet e sigurimeve shoqërore, nëse kjo është vendosur me një vendim gjyqësor ose administrativ që ka efekt të formës së prerë dhe detyrues në një nga Palët e kësaj marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.4 Kanë kryer shkelje të rënda, të konstatuara përfundimisht, në lidhje me detyrimet mbi shëndetin dhe sigurinë në punë, të drejtën mjedisore, sociale dhe të punës në një nga Palët e kësaj marrëveshje ose në shtetin në të cilin janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.5 Gjenden në një nga situatat e mëposhtme ose i nënshtrohen një procedure për konstatimin e falimentimit, likuidimit të detyrueshëm administrativ, marrëveshjes me kreditorët, pranimit të marrëveshjes me vazhdimësi të biznesit ose ndodhen në çdolloj situate të ngjashme;

1.6.6 Janë fajtorë për kundërvajtje të rënda profesionale, që autoriteti kontraktor është në gjendje të provojë me mjetet e duhura, të tilla që e bëjnë të dyshimtë integritetin ose profesionalizmin e tyre;

1.6.7 Janë ata, apo subjektet që i përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë të bashkimeve të

operatorëve, shoqërive të përkohshme dhe nënkontraktore, në konflikt interesi lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procesin e tenderimit për shkak se i kanë siguruar konsulencë administratës, që ka kompetencën për të dhënë kontrata publike ose organit caktues të tenderit, ose kanë marrë pjesë në përgatitjen e procedurës së dhënies së kontratës.

1.6.8 Kanë lëshuar për autoritetin e njërit prej Shteteve Palë në këtë Marrëveshje, deklarata të rreme në procedurën në proces dhe në dhënien e nënkontratave në sigurimin e informacionit të kërkuar për të verifikuar mungesën e arsyeve për përjashtimin ose respektimin e kritereve të përzgjedhjes, ose kanë fshehur këto informacione ose janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Kombëtar Kundër Korrupsionit të Republikës Italiane për paraqitjen e deklaratave të rreme ose dokumentacionit të rremë me qëllim lëshimin e dëshmisë së kualifikimit.

1.6.9 Janë prekur nga një shkak i rënies së të drejtës, pezullimit ose ndalimit të parashikuar nga legjislacioni i të dyja Palëve kontraktuese në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit;

1.6.10 I janë nënshtruar, për arsye të kundërvajtjeve administrative që rrjedhin nga vepra penale të vërtetuara me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërën prej Palëve të kësaj marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin janë vendosur ose inkorporuar, një sanksioni që përfshin ndalimin e kontraktimit me administratën publike;

1.6.11 Kanë shkelur ndalimin e marrjes së besueshmërisë parashikuar në legjislacionin e njërës prej Palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e marrësve si persona ndërmjetës në shoqëritë e besimit.

1.6.12 Nuk janë në përputhje me rregullat që disiplinojnë të drejtën për punë të personave me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të vendit të cilit i përket autoriteti kontraktor;

1.6.13 Ndodhen në raport me një tjetër pjesëmarrës në të njëjtën procedurë besimi, në situata kontrolli ose në çdolloj marrëdhënie tjetër, edhe faktike, nëse situata e kontrollit ose marrëdhënia bën që ofertat t'i atribuohen një qendre të vetme vendimmarrëse;

1.6.14 Kanë lidhur kontrata punësimi ose vetëpunësimi dhe gjithsesi i kanë caktuar detyra ish-punonjësve të autoritetit kontraktor, që kanë ndërprerë marrëdhëniet e tyre të punës prej më pak se tre vitesh dhe që në tre vitet e fundit të shërbimit kanë ushtruar fuqi autoritare ose negociuese për llogari të këtij autoritet kontraktor kundrejt të njëjtit operator ekonomik.

1.7 Një operator ekonomik duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit edhe në rastin kur arsyet për përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 1.6 kanë të bëjnë me një anëtar të këshillit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të këtij operatori ekonomik, ose një person që ka të drejta të tilla përfaqësimi, vendimi ose kontrolli.

2. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË KONTRAKTUESIT

2.1 Dhënia dhe ekzekutimi i kontratave të punëve, shërbimeve, furnizimeve dhe koncesioneve, garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe zhvillohen në përputhje me parimet ekonomike, efektivitetit, kohës dhe korrektësisë. Në dhënien e kontratave dhe koncesioneve, Autoritetet Kontraktuese, gjithashtu respektojnë parimet e konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe publicitetit. Parimi ekonomik mund t'u nënshtrohet, brenda kufijve të lejuara shprehimisht nga ligjet në fuqi, kritereve të parashikuara në njoftim, të frymëzuara nga nevojat sociale, si dhe mbrojtja e shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, edhe nga pikëpamja energjetike.

2.2 Dhënia e procedurës së tenderit ose koncesionit nuk mund të ketë si qëllim kufizimin artificialisht të konkurrencës, me qëllim për të favorizuar apo disavantazhuar padrejtësisht disa operatorë ekonomikë ose punime, furnizime dhe shërbime të caktuara.

2.3 Kriteret për pjesëmarrje në tender duhet të jenë të tilla që të mos përjashtojnë mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

2.4 Dokumentacioni i tenderit specifikon fondin limit të kontratës që do të jepet. Ofertat për vlera më të larta përjashtohen automatikisht.

2.5 Procedura e përzgjedhjes së kontraktuesit anulohet nëse janë paraqitur më pak se tre kandidatura/oferta të pranueshme. Nëse kushtet objektive të tregut e bëjnë shumë të vështirë paraqitjen e tri ofertave të përshtatshme, njoftimi i

tenderit mund të lejojë shpalljen e fituesit edhe në prani të një ose dy ofertave të vlefshme.

2.6 Secili konkurrent nuk mund të paraqesë më shumë se një ofertë. Me paraqitjen e ofertës në një tender, konkurrentët deklarojnë që nuk kanë ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe asnjë lidhje të veçantë me konkurrentët e tjerë apo palët e tjera në pozita të ndryshme të përfshira në projekt.

2.7 Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentacionin e tenderit, variantet e ofertës nuk janë të autorizuara. Variantet janë të lidhura me objektin e tenderit.

2.8 Për pjesëmarrje në procedurat e përzgjedhjes që i nënshtrohen autorizimit të AICS-së, autoriteti kontraktor kërkon që ofertuesit të ofrojnë një sigurim të garancisë në një shumë të barabartë me 2% të vlerës limit të tenderit. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurime, ato duhet të parashikojnë heqjen dorë nga përfitim i detyrimit paraprak të pagesës së debitorit kryesor dhe të jenë operative me kërkesë të thjeshtë me shkrim të Autoritetit kontraktues. Sigurimi i garancisë së kontratës kërkohet, në rast mosnënshkrimi të kontratës që i atribuohet kontraktuesit.

3. ZBATIMI I KONTRATAVE

3.1 Zbatimi i kontratave për kontratat që do të lidhen në vijim të një procedure përzgjedhjeje që i nënshtrohet autorizimit të AICS-së, garantohet me një garanci prej 10% të vlerës së kontratës. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurime, ato duhet të parashikojnë heqjen dorë nga përfitimi i detyrimit paraprak të pagesës së debitorit kryesor dhe të jenë operative me kërkesë të thjeshtë me shkrim të Autoritetit kontraktues. Garancitë e zbatimit të kontratës duhet të përfshijnë, në dokumentacionin e tenderit, thirrjen, në rast mashtrimi, ose mospërmbushje të rëndë të kontratës, të zbatuesit të saj. Garancitë e zbatimit çlirohen në mënyrë progresive në përputhje me ecurinë e zbatimit dhe në çdo rast brenda kufirit maksimal prej 80% të shumës së garantuar. Pjesa e mbetur prej 20% çlirohet pas verifikimit të zbatimit të rregullt.

3.2 Kontratat mund të modifikohen gjatë zbatimit me miratimin paraprak të AICS-së dhe brenda kufijve të parashikuar në nenin 72 të direktivës 2014/24/BE. Shuma e ndryshimeve, gjithsesi nuk mund të tejkalojë burimet e përgjithshme financiare të parashikuara për zbatimin e Marrëveshjes. Miratimi i ndryshimeve mund të refuzohet në qoftë ato e bëjnë të pamundur ose jashtëzakonisht të pamundur ekzekutimin e të gjithë komponentëve të nismës së parashikuar nga Marrëveshja.

Kontraktuesit nuk kanë të drejtë për ndonjë pagesë ose rimbursim për ndryshimet e bëra pa autorizimin paraprak nga AICS-ja. Me kërkesë të AICS-së ose nga autoriteti kontraktor, kontraktuesi siguron, me shpenzimet e veta, që ta rikthejë atë në gjendjen e mëparshme.

3.3 Autoriteti kontraktor, nëse gjatë zbatimit është e nevojshme shtimi ose reduktimi i shërbimeve deri në arritjen e një të pestës së vlerës së kontratës, mund t'i imponojë kontraktuesit ekzekutimin me të njëjtat kushte të parashikuara në kontratën fillestare. Në këtë rast kontraktuesi nuk mund ta zgjidhë kontratën.

3.4 Kontratat nuk mund t'u jepen palëve të treta, gjë e cila çon në zgjidhjen ligjore të kontratave. Dhënia është e pranueshme, me miratim paraprak të AICS-së, vetëm nëse kontraktuesi fillestar përfshin, për shkak vdekjeje apo pas ristrukturimit të shoqërive, duke përfshirë zëvendësimin, shkrirjen, bashkimin, blerjen dhe paaftësinë paguese, një operator tjetër ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes cilësore të përcaktuara fillimisht, me kusht që të mos implikojë ndryshime të tjera thelbësore në kontratë dhe të mos ketë si qëllim shmangien e zbatimit të kësaj shtojce.

3.5 Kohëzgjatja e kontratës mund të modifikohet ekskluzivisht për kontratat në proces zbatimi, nëse një mundësi zgjatjeje është parashikuar në dokumentet e tenderit. Në këtë rast kontraktuesi është i detyruar të kryejë shërbimet e ofruara në kontratë me çmime, afate dhe kushte të njëjta ose më të favorshme për autoritetin kontraktor.

3.6 Pa cenuar respektimin e detyrimeve të gjurmueshmërisë sipas paragrafit 3.9, dhëniet e kredive nga vlera e tenderit, koncesionit, konkursit të projektimit, janë efektive dhe të kundërshtueshme ndaj Qeverisë italiane vetëm me miratimin paraprak të AICS. Në çdo rast, autoriteti kontraktor, të cilit i është njoftuar dhënia, duhet të ruajë të drejtën për t'i kundërshtuar dhënësit të gjitha përjashtimet e kundërshtueshme ndaj dhënësit në bazë të kontratës lidhur me punët,

shërbimet, furnizimet, planifikimin, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

3.7 Titullarët e detyrave të projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësuara nga autoritetet kontraktore, si rezultat i gabimeve ose mangësive të projektimit. Në rastin e kontratave që kanë si objekt projektimin ekzekutiv dhe zbatimin e punimeve, kontraktuesi është përgjegjës për vonesat dhe kostot që rrjedhin nga nevoja për të bërë ndryshime për shkak të mangësive në projektin e zbatimit.

3.8 Nënkontraktimi pranohet deri në një maksimum prej 30% të vlerës totale të kontratës. Dokumentacioni i tenderit specifikon kushtet e nënkontraktimit. Konkurrentët duhet të deklarojnë në ofertat e tyre, cilat furnizime, shërbime ose punime synojnë të nënkontraktojnë. Ofertuesit depozitojnë kontratat e nënkontraktimit pranë Autoritetit Kontraktor para fillimit të punimeve të nënkontraktimit. Kontraktuesit kryesorë marrin përgjegjësinë e plotë për të gjithë kontratën kundrejt Autoritetit Kontraktor. Nënkontraktuesit duhet të plotësojnë kërkesat në përputhje me paragrafin 1.2 për shërbimet që duhet të kryhen dhe që të mos shkaktojnë arsyet e përjashtimit të parashtruara në paragrafët 1.6 dhe 1.7. Konkurrenti ose kontraktuesi zëvendësojnë nënkontraktorët që ndeshen me arsye përjashtimi.

3.9 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen në euro ose në monedhë tjetër të parashikuar shprehimisht nga Marrëveshja. Risqet dhe ndryshimet në kursin e këmbimit nuk do të jenë në këtë rast subjekt i asnjë kompensimi.

3.10 Pagesat bëhen me metoda të gjurmueshme, sipas afateve të parashikuara nga kontrata, të cilat marrin parasysh ecurinë efektive të zbatimit. Qeveria italiane i kryen Palës tjetër kontraktuese kreditimin e parashikuar nga marrëveshja në një llogari bankare dedikuar ekskluzivisht për zbatimin e marrëveshjes. Në kontrata është e përfshirë një klauzolë që detyron kontraktuesin, dhe nënkontraktorët për të përdorur për pagesat një llogari bankare të dedikuar.

3.11 Kontrata zgjidhet me ligj nëse fituesit e kontratës janë subjekt i procedurave të falimentimit, të likuidimit të detyrueshëm, administrimit gjyqësor ose marrëveshjes me kreditorët, apo gjenden në ndonjë situatë të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar përkatës.

3.12 Në rast mashtrimi apo faji të rëndë, nuk lejohet kufizimi i përgjegjësisë së kontraktuesve, ose nënkontraktuesve.

3.13 Zbatimi i kontratës rregullohet nga ligji kombëtar i autoritetit kontraktor, përveç nëse është parashikuar ndryshe në Marrëveshje dhe në këtë Shtojcë.

3.14. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet fituesve të tenderit dhe autoritetit kontraktor nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

3.15 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e lartpërmendura.

4. KOSTOT E PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME

4.1 Kostot që rezultojnë në kontratë janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për realizimin e projektit sipas dokumentit të projektit.

4.2. Në çdo rast, nuk janë të pranueshme kostot që lidhen me:

4.2.1 Mallrat e panevojshme ose të luksit;

4.2.2 Mallrat, shërbimet dhe punët civile, të lidhura direkt ose indirekt me veprimtaritë ushtarake;

4.2.3 Taksat, tarifat indirekte, duke përfshirë TVSH-në, dhe detyrimet doganore ndaj Shtetit të cilit i përket autoriteti kontraktor;

4.2.4 Amortizimi i borxheve të marra më parë dhe humbjet e ardhshme të autoritetit kontraktor ose të përdoruesve të fundit;

4.2.5 Interesat ndaj të tretëve nga Autoriteti Kontraktor ose nga përdoruesit e fundit.

5. KLAUZOLAT ETIKE

5.1 Çdo përpjekje, nga ana e konkurrentëve (potencialë ose jo) për të marrë informacion konfidencial, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentët e tjerë, ose për të ndikuar autoritetin kontraktor në fazat e analizës, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, sjell përjashtimin e konkurrentit nga tenderi, dhe si rrjedhojë eliminimin e ofertës së tij.

5.2 Personeli që punon në administratën publike të palëve kontraktuese të Marrëveshjes, pavarësisht nga pozicioni i veçantë administrativ në të cilën ndodhet, nuk mund të punësohet si ekspert ose konsulent nga operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tender.

5.3 Fituesit e tenderit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje në kodin e sjelljes

së profesioneve përkatëse. Ata nuk bëjnë deklarata publike mbi projektin ose shërbimet që kërkohen prej tyre, pa miratimin paraprak të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, ata nuk angazhojnë në asnjë mënyrë autoritetin kontraktor pa pëlqimin paraprak me shkrim të tij.

5.4 Për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e tenderit respektojnë të drejtat e njeriut dhe marrin përsipër të mos shkelin parimet, zakonet dhe traditat politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti, fituesit e tenderit respektojnë standardet themelore të punës të përcaktuara nga Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në fuqi për vendin partner dhe për Italinë. Në çdo rast, sigurohet respektimi i dispozitave të "Konventës për lirinë sindikale dhe mbrojtjen e së drejtës sindikale", të "Konventës mbi të drejtën e organizimit dhe të negocimit kolektiv" të "Konventës mbi punën e detyruar", e plotësuar me protokollin e vitit 2014, të "Konventës mbi diskriminimin (punësimin dhe profesionin)", të "Konventës për format më të këqija të punës së të miturve", të "Konventës për mbrojtjen e amësisë", të "Konventës për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi", të "Konventës kuadër të sigurisë në punë dhe shëndetësi".

5.5 Fituesit e tenderit nuk pranojnë pagesa në lidhje me kontratën, përveç atyre të parashikuara në të. Fituesit e tenderit nuk kryejnë asnjë aktivitet dhe as nuk përfitojnë asnjë avantazh nga autoriteti kontraktor, që nuk është në përputhje me detyrimet kontraktuale përkatëse.

5.6 Fituesit e tenderit e ruajnë sekretin profesional gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe madje edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të pranuara nga kontraktuesi janë konfidenciale.

5.7 Fituesit e tenderit shmangin çdo marrëdhënie që mund të cenojë pavarësinë e tyre, ose atë të personelit të tyre ose ndonjë konflikt tjetër interesash. Nëse fituesit e tenderit ndalojnë së qeni të pavarur ose nëse konfliktet e interesit lindin gjatë zbatimit të kontratës, ata informojnë menjëherë autoritetin kontraktor. Autoriteti kontraktor mund ta zgjidhë kontratën pa njoftim dhe pa bërë të mundur që fituesi i tenderit të ngrejë pretendime për dëmshpërblim.

5.8 Qeveria italiane rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar financimin e projektit, nëse praktikat e korrupsionit të çdo lloji shfaqen në çdo fazë të procedurës së dhënies së kontratës, dhe nëse Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të marrë të gjitha masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar. Për qëllimet e kësaj klauzole, "praktikat e korrupsionit" janë ofertat e ryshfetit, dhuratat, donacione ose komisione, që konsiderohen si stimul ose shpërblim për cilindo person që ka kryer ose ka abstenuar nga kryerja e çfarëdo veprimi në lidhje me caktimin ose përmbushjen e një kontrate të lidhur tashmë me autoritetin kontraktor.

5.9 Dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përfshijnë një klauzolë që parashikon anulimin e procedurës së tenderit ose zgjidhjen e kontratës të lidhur tashmë, edhe pse është në proces zbatimi apo është zbatuar, nëse dhënia ose zbatimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime tregtare të pazakonta.

"Shpenzimet tregtare të pazakonta" janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore, ose nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur në mënyrë korrekte dhe që i referohen kontratës kryesore, komisionet e paguara jo si rrjedhojë e shërbimeve të ligjshme dhe të kryera realisht, komisionet e paguara në një parajsë fiskale, komisionet e paguara një përfituesi jo qartësisht të identifikueshëm, apo komisionet e paguara për një kompani mbulimi.

5.10 Kontraktuesit, me kërkesë të AICS-së, ofrojnë elemente provuese për të shpjeguar kushtet në të cilat ekzekutohet kontrata. Autoritetet kompetente të Republikës Italiane mund të kryejnë çdo kontroll, në dokumentacion ose në terren, që e gjykojnë të nevojshëm, për të mbledhur elemente provuese në rastet e dyshimit për shpenzime tregtare të pazakonta ose praktika të dyshimta të korrupsionit.

5.11 Fituesit e tenderit që kanë bërë shpenzime tregtare të pazakonta në projekte të financuara nga fondet italiane janë subjekt, sipas rëndesës së fakteve të konstatuara, i zgjidhjes së kontratës ose i përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me financime nga qeveria italiane.

5.12 Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave etike nga ana e konkurrentit ose fituesit të tenderit mund të përcaktojë përjashtimin e tij nga kontratat e tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, nga fondet italiane për ndihmë zhvillimore dhe zbatimin e penaliteteve të parashikuara në kontratë. Individi ose shoqëria e

konsideruar/përgjegjëse duhet të informohet me shkrim për faktin.

